



Pranuar / Dorezuar Puniljeno / Prudato Received / Delivered	20.04.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRASHKËK	2271/2022		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.265/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2523/201 të datës 17.03.2022 të Gjyqates Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.771/2021 të datës 26.08.2021 të parashtruar nga ankuesi

rruga Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Komunes së Podujevës në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.771/2021 e datës 26.08.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.13-112/12-006969/21 i datës 16.08.2021 i Menaxherit të Personelit në Komunë Podujevës.

A r s y e t i m

Komuna e Podujevës me datë 24.06.2021 ka publikuar konkursin me numër RN00007180 për pozitën “Specialist të Auditimit të Brendshëm”, sipas afatit për aplikim nga data 15.07.2021 deri me datë 29.07.2021, duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesi për këtë pozitë ka aplikuar me datë 16.07.2021 me numër reference të shpallur RN00007180, ndërsa me datë 11.08.2021 Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e

Podujevës në fazën e verifikimit të dokumentacionit, ka nxjerrë Vendim nr.13-111/01-0067662/21 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit të datës 16.07.2021, mbi bazën se ankuesi nuk i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të arsimimit sipas kushteve të shpallura në konkursin në fjalë.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin mbi refuzimin e aplikacionit, me datë 12.08.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 13-112/12-0068246/21 tek Udhëheqësi i Personelit në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Komunë të Podujevës. Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës, me datë 16.08.2021 nxjerr Vendim me Nr.12-112/12-00696396/21 me të cilin e refuzon ankesën e ankuesit të datës 12.08.2021, si të pa bazuar duke lënë në fuqi Vendimin me numër nr.13-111/01-0067662/21 të mos plotësimin të kushteve të konkursit të datës 11.08.2021.

Kundër Vendimit me Nr.12-112/12-00696396/21 të Menaxherit të Personelit të Komunës së Podujevës të datës 16.08.2021, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë me datë 26.08.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. Protokolli4412/2021, me pretendime ankimore se i plotëson kushtet për pozitën " Specialist për Auditim të Brendshëm".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.09.2021 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Podujevës, të cilën me datë 14.09.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 12.10.2021 përmes Njoftimit me Nr.Prot: 4998/2021, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën me numër A.nr.771/2021 të datës 26.08.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 17.03.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2523/21, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 12.10.2021 të KPMSHCK-së dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit me numër A.nr.771/2021 të datës 26.08.2021.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:** Aktgjykimi me numër Anr.2523/21 i Gjykatës Themelore-Departamenti Administrativ i datës 17.03.2022 i pranuar me datë 22.03.2022 në Këshill me nr. protokolli 1506/22; Ankesën e ankueses me Nr.Prot:4412/2021 të datës 26.08.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me numër rendor Anr.771/2021; Vendimin me Nr.12-112/12-00696396/21 i datës 16.08.2021 i Menaxherit të personelit; Vendimi nr.13-111/01-0067662/21 i datë 11.08.2021 i Menaxherit të personelit, për mos plotësimin e kushteve për aplikim; Certifikat e programit kombëtar për trajnimin e Auditorëve të Brendshëm -shkurt 2020; Diplomë e datës 05.05.2014 lëshura nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Ekonomiks me nr.4389; Çertifikat plotësuese-Auditor i certifikuar nr.protokolli 0312 dhe 0143 e datës 30.09.2019; Çertifikat plotësuese-Auditor i certifikuar nr.protokolli 0312 dhe 083 e datës 10.04.2018; Çertifikat -kontabilist i certifikuar datë 05.04.2018; Certifikat Teknik i kontabilitetit e

datës 20.12.2016; Certifikat-Auditor i certifikuar e datë 19.08.2019; Përgjigje në ankesë e datë 14.09.2021; Plani i personelit 2021; Shpallja e konkursit sipas njoftimit të datës 24.06.2021, afati i aplikimit nga data 15.07.2021 deri me datës 29.07.2021; CV e ankuesite datës 16.07.2021 ; Çertifikat e datë 2.06.2021 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Certifikat lëshuar nga shkolla e gjuheve të huaja "Zastrade" e datë 07.10.2008 dhe e datës 03.03.2008; Certifikat e datë 3.12.2016 sigurimet shendetesore; Certifikat e datë 12.12.2019 kodi etikes për kontabilitet profesional"; Certifikat e datë 30.06.2018 "e drejtapër të zbritur TVSH-në dhe rregullimet e zbritjes"; Certifikat e datës 11.05.2019 "qasja praktike në auditimin e jashtëm"; Certifikat e datës 11.04.2020 "ndryshimet e fundit tatimore dhe deklarata vjetore"; Certifikat e datë 2.12.2020 "zbatimi i praktikave dhe procedura e auditimit të jashtëm"; Certifikata e datës 26.11.2020 " roli i kontabilistëve në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave"; Certifikat e datë 14.11.2020 " Ngjarja e tarifueshme e TVSH-së e drejta për të zbritur TVSH-në dhe rregullimet e zbritjes"; Certifikat "menaxher i guzimit"; Kontrat e punë datë 02.02.2016 deri me datë 02.05.2016 NTP "Marigona" në Podujevë; Pasqyra e trustit nga data 01.01.2015 deri me date 30.06.2021; Vërtetim i datës 01.09.2020 mbi angazhimin e kryerjes së shërbimeve në auditim nga data 01.06.2020 der me date 31.08.2020 lëshuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit; Lista e aplikanteve të aprovuar dhe të refuzuar, e nxjerr nga SIMBNJ; Njoftimi i datë 1.08.2021 për kandidatët që vazhdojnë fazën e mëtejme të rekrutimit; Formulari i ankesë i datës 12.08.2021 nga ankuesja; Vërtetimim i datës 12.08.2021 i Komuës së Podujeves mbi tatimin; E-maili i datë 16.08.2021 lidhur me dërgimin e Vendimit të ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Podujevës me datë 24.06.2021 ka publikuar konkursin me numër RN00007180 për pozitën "Specialist të Auditimit të Brendshëm", sipas afatit për aplikim nga data 15.07.2021 deri me datë 29.07.2021 , duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe nenit 7 dhe nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesi për këtë pozitë ka aplikuar me datë 16.07.2021 me numër reference të shpallur RN00007180, ndërsa me datë 11.08.2021 Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës në fazën e verifikimit të dokumentacionit, ka nxjerrë Vendim nr.13-111/01-0067662/21 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit të datës 16.07.2021, mbi bazën se ankuesit i mungon përvoja e punës pas diplomimit e që sipas konkursit në fjalë është së paku dy (2) vite.

Sipas konkursit me numër reference me numër RN00007180 i shpallur me datë 24.06.2021 për pozitën "Specialist të Auditimit të Brendshëm", në Komunën e Podujevës, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Diplomë të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS, apo ekuivalente me to (në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor). Drejtimi Ekonomik specialiteti financë dhe/apo kontabilitete Drejtësi,*
- *Kualifikim të posaçëm formal: Certifikata për auditor të brendshëm, Licenca sipas legjislacionit në fuqi, apo trajnime të tjera kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase,*



•Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar pese (5) kandidatë, prej tyre veten dy i kanë plotësuar kriteret e konkursit dhe janë ranguar në listën e ngushtë, ndërsa ankuesi i cili ka aplikuar për këtë pozitë të punës, nuk është përfshirë në listën e ngushtë nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës në fazën e verifikimit të dokumentacionit, sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të arsimit sipas kushteve të shpallura në konkursin në fjalë „Diplomë të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS, apo ekuivalente me to (në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor)‘.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit të datës 24.06.2021 për pozitën “Specialist të Auditimit të Brendshëm” me numër RN00007180 në Komunën e Podujevës, gjegjësisht i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të arsimit sepse edhe trajnimet dhe certifikatat e auditimit janë ekuivalente me titujt e arsimit të lartë dhe konsideroj se mos përfshirja në listë të ngushtë është e padrejtë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave ka konstatuar se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse ankuesi në dosjen e bashkangjitur me rastin e aplikimit posedon vetëm Diplomën e datës 10.07.2014 me nr.4389 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Ekonomik në Degën Ekonomiks dhe ka marr titullin Baçelor për Ekonomiks me 180 ECTS/kredi, andaj Kolegji nga analizimi i dosjes se aplikimit të ankuesit ka gjetur se ankuesi nuk i ka përmbushur kërkesat e konkursit me numër të referencës RN00007180, përkatësisht nuk e ka plotësuar kriterin themelor të këtij konkursi siç përcaktohet në nenin 13, 18 dhe nenin 28 paragrafin 3 të Rregullores (QRK)Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe Shtojcën Nr.1/8: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 1 dhe Shtojcën Nr. 2 Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm të kësaj rregulloreje.

Andaj, duke marrë parasysh konstatimin si me lartë, Kolegji vlerësoj se Divizioni i Burimeve Njerëzore i Komunës së Podujevës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.12-112/12-00696396/21 të datës 16.08.2021, me të cilin ka refuzuar aplikacionin e ankuesit të datës 16.07.2021 për shkak të mos plotësimit të kërkesës së përgjithshëm formale të konkursit me numër të referencës RN00007180 për pozitën “Specialist i Auditimit të Brendshëm”, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe duke zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar në pajtim me nenin 15 paragrafin 1, 2 dhe 5 të Rregulloren (QRK)Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: “ 1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak.... 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve...”, sepse i njëjti ka përfunduar studimet themelore në Universitetin e

Prishtinës "Hasan Prishtina" në Fakultetin Ekonomiks me datë 05.05.2014, dhe marr titullin Bachelor për Ekonomiks, me 180 ECTS/kredi, dhe në bazë të provave të lëndës nuk ka ndonjë diplomë tjetër tw studimeve postdiplomike Master, apo vazhdim (specializim) të Diplomës Bachelor, ndërsa Certifikata, Licenca janë kualifikime të posaçme formale kur kërkohen me legjislacionin apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e caktuara, andaj ankuesi nuk e ka përmbushur kërkesën e përgjithshme formale të arsimimit respektivisht nuk e ka përmbushur kriterin e kredive me gjithsejtë 240, siç është kërkuar në konkursin e datës 24.06.2021.

Andaj Kolegji konstaton se konkursi me numër RN00007180 për pozitën "Specialist të Auditimit të Brendshëm" i publikuar nga Komuna e Podujevës me datë 24.06.2021 është zhvilluar në pajtim me nenin 34 paragrafin 6 nën paragrafin 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK)Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.265/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunë të Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

